



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
ZYRA E ADMINISTRIMIT TË PARKUT KOMBËTAR “LUMI I VJOSËS”

**SHPALLJE PËR POZICIONIN PËRGJEGJËS NË SEKTORIN E MENAXHIMIT NË
ZYRËN E ADMINISTRIMIT TË PARKUT KOMBËTAR “LUMI I VJOSËS”**

Në mbështetje të VKM-së nr.774, datë 13.12.2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës” (ZAPK Vjosa), *institucion në nivel rajonal (Gjirokastrë), në varësi të ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura mjedisore*, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.19, datë 3.2.2025 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës”, si dhe të Urdhrit të Drejtorit të ZAPK Vjosa “Për ngritjen e Komisionit Ad Hoc”, nr.24, më datë 03.11.2025, shpallet pozicioni vakant i punës:

**PËRGJEGJËS NË SEKTORIN E MENAXHIMIT NË ZYRËN E ADMINISTRIMIT TË
PARKUT KOMBËTAR “LUMI I VJOSËS”**

**Afati për dorëzimin e dokumenteve 10/11/2025 pranë Zyrës së Administrimit të Parkut
Kombëtar “Lumi i Vjosës”**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Hartimi dhe zbatimi i planit të menaxhimit, projekteve restauruese dhe konservuese, projekteve kërkimore-shkencore;
- Planifikimi i nevojave për trajnime dhe koordinimi i punën për realizimin e tyre;
- Koordinimi dhe asistimi i ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për nismat e menaxhimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës”;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e fushave përkatëse për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme në territorin e Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës”;
- Mbështetja e ministrisë përgjegjëse për mjedisin për të përgatitur propozimet për ndryshime dhe përmirësime të kuadrit ligjor dhe nënligjor që lidhen me zonat e mbrojtura dhe natyrën;
- Koordinimi së bashku me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e administratës publike dhe partnerët ndërkombëtarë planifikimin e nevojave për investime, bazuar në politikat e qeverisë dhe në planin e menaxhimit të Parkut;
- Menaxhimi i proceseve që lidhen me kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes dhe punimeve me karakter restaurues e konservues në funksion të masave ruajtëse dhe mbrojtëse në zonat e mbrojtura që ka në administrim;
- Koordinimi i punës me institucionet e administratës publike, në nivel qendror dhe vendor, partnerët ndërkombëtarë, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e standardeve dhe aktiviteteve të planit të menaxhimit.

KUSHTET PËR PRANIM DHE KRITERET E VEÇANTA për pozicionin Përgjegjës Sektori

Kandidatët për “Përgjegjës Sektori” duhet të plotësojnë kushtet për pranim si dhe kriteret e veçanta si vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë diplomë të ciklit të dytë të studimeve sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, në shkenca mjedisore, natyrore, ekonomike, juridike, inxhinierike.
- Të ketë përvojë pune të paktën 1 vit pune në profesion;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës.
- Të ketë njohuri shumë të mira profesionale të çështjeve teknike dhe aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punën e stafit nën varësi;
- Të ketë aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritetet dhe respektuar afatet;
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;
- Të ketë aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja
- Të kenë aftësi të mira menaxheriale dhe të procedurave administrative;
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës/diplomave dhe listës së notave të noterizuara;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (në momentin e fillimit të marrëdhënieve të punës);
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g. Dy referenca nga punëdhënësi apo bashkëpunëtorë të mëparshëm;
- gj. Certifikata për trajnime në lidhje me pozicionin për të cilin konkurrojnë;
- h- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në protokollin e Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës”, brenda datës 10/11/2025.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Komisioni Ad-Hoc do të shpallë në faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit www.mjedisi.gov.al, tek kategoria/menuja “Njoftimet”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për intervistën e strukturuar me gojë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e mos kualifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të intervistohen për njohuritë mbi dokumentet e listuara më poshtë:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 10431, datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Njohuri mbi Vendimin nr.774, datë 13.12.2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës (ZAPK Vjosa).

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen edhe në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me fushën e njohurive (pjesë e kësaj shpalljeje), si dhe kompetencën mbi organizimin dhe menaxhimin e veprimtarisë drejtuese;
- b- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE KOMUNIKIMI

Kandidatët do të vlerësohen me pikë si më poshtë:

- a- Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 60 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 40 pikë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia përgjegjëse pranë ZAPK Vjosa do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesit në faqen zyrtare të ministrisë.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentacioneve të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda **datës 10.11.2025** në protokollin e ZAPK Vjosa;

Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet **në datën 17.11.2025, në ambientet e Ministrisë së Mjedisit.**

